



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.
PUBLIC HOUSING ENTERPRISE J.S.C.

Adr: Rr. Bill Clinton pn. Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: *01-02-1044/1* Data: *11.09.2010*

**NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I STATUTIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE
BANESORE Sh.A, PRISHTINË**

Prishtinë, Shtator 2018

Në bazë të dispozitave të nenit 102 dhe nenit 41 që ndërlidhet me nenin 128 të Ligjit 06/L-016 për Shoqëritë tregtare, nenit 5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike nr. 03/L-087, dhe nenit 9.2 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banësore SH.A, Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banësore Sh.A në mbledhjen e mbajtur më 10.09.2018 miraton këtë:

NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË STATUTIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE BANËSORE, SH.A PRISHTINË I MIRATUAR MË 05.07.2011

Neni 1

Me këtë Statut përcaktohen parimet themelore për organizimin dhe fushveprimtarinë e Ndërmarrjes Publike Banësore Sh.A, në Prishtinë në tekstin e mëtejshëm-NPB Sh.A në Prishtinë).

Neni 2

Neni 2 i Statutit bazik, në paragrafin 2.1 ndryshohet si në vijim:

2.1 Ndërmarrja Publike Banësore Sh. A është themeluar mbështetur në Ligjin 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-111, poashtu mbështetur në Ligjin 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare,

Neni 3

Neni 3 i Statutit bazik ndryshohet si në vijim :

3.1 Selia e NPB Sh. A është në Prishtinë, Rr. Xhevdet Doda, nr 32

Neni 4

Neni 5 të Statutit bazik i shtohet paragrafi 5.4 si në vijim;

5.4 Në mungesë të Bordit të Drejtorëve, vendimi sipas paragrafit 5.3 të këtij neni merret nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, me shumicë votash.

Neni 5

Neni 7 të Statutit bazik i shtohet paragrafi 7.1.7 si në vijim:

Me vendim të veçantë të Komisionit Komunal të aksionarëve si organi më i lartë vendimmarrës, mund të shtohet fushëveprimtaria e Ndërmarrjes Publike Banësore.

Neni 6

Neni 8 i Statutit bazik, paragrafi 8.2 ndryshohet si në vijim:

Ndërmarrja Publike Banesore Sh. A është themeluar mbështetur dhe në zbatueshmëri në Ligjin 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-111, poashtu mbështetur në Ligjin 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare,

Neni 7

Neni 9, paragrafi 9.3 i Statutit bazik, riformulohet si në vijim;

9.3 Ky statut i miratuar, ndryshuar apo plotësuar ka efekt juridik vetëm pas miratimit nga Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe pas dorëzimit të të njejtit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës.

Neni 8

Neni 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 plotësohen si në vijim:

12.1 Prona e NPB Sh.A në Prishtinë është në vlerë prej 74 milion euro. Kapitali është verifikuar dhe nënshkruar.

12.3. Në paragrafin 3 të këtij neni ndryshohet baza ligjore, pra në vend të Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, zëvendësohet me “ sipas përcaktimit në Ligjin 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare,

Neni 10

Pas paragrafit 18.8 të Statutit Bazik shtohet paragrafi 18.9 dhe 18.10 si në vijim;

18.9 Njoftimi i mbledhjeve urgjente të Aksionarëve duhet të bëhet në afat prej 3 ditësh nga data e mbajtjes së mbledhjes, ndërsa materialet duhet të dorëzohen së paku 24 orë më herët me postë apo përmes emailit.

18.10 Mbledhjet urgjente të Aksionarëve mund të thirren nga secili aksionar që përfaqëson së paku 25 % të aksioneve të shoqërisë.

Neni 23 i Statutit bazik paragrafi 2 ndryshohet si në vijim:

23.2 Bordi i Drejtorëve, formohet dhe vepron në bazë të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe


plotësuar me ligjin nr. 04/L-111, poashtu mbështetur në Ligjin 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare si dhe në përputhje me Rregulloren e Brendshme për Bordin të Ndërmarrjes Publike Banesore.

Pas nenit 23.2 shtohet neni 23.3 si vijon:


23.3 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv apo zyrtarëve të tjerë të lartë përcaktohet me një aneks të veçantë që do t'i bashkëngjiten këtij Statuti.

Këto plotësime ndryshime hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga aksionarët dhe dorëzimit të të njejtit në ARBK.

Komisioni Komunal i Aksionarëve


Dren Kukaj

Syzanë Kika


Genc Sherifi